REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Kavajë, më _____._____.2025

PROJEKT - VENDIM

Nr._____date._____._____. 2025

PER MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TE INVESTIMEVE ME KODE PROJEKTI TE MIRATUAR ME VKB NR.06 DATE 25.02.2025

Ne mbledhjen e tij te dates_ . .2025, me propozim te Kryetarit te Bashkise, mbeshtetur ne nenin 9 pika l.3 shkronja "c", 34, 40, 41, 54 shkronja "dh" te ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41 te ligjit nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 9936, date 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar, ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin"te ndryshuar; Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 23 date 30.07.2018 "Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV", Udhezimi nr.08 date 28.02.2025''Per pergatitjen e PBA 2026-2028''Shkresa nr.4074/1 dt.04.03.2025 ''Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026-2028,Parashikimet e Transfertave te Pakushtezuar te Pergjithsshme dhe Sektoriale''Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 9 date 20.03.2018 "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar dhe Relacionit te Administrates se Bashkise Kavaje,Drejtorise se Kultures,Trashegimise Kulturore dhe Sporteve.

I PROPOZON:

1. Keshillit Bashkiak te miratoje ndryshimet midis Investimeve ''Rikonstruksioni I Rruges Pavaresia Qerret'' dhe ''Rikonstruksioni I bustit Josif Budo"

se e ketij vendimi eshte dhe dokumentacioni shoqerues (Relacioni) i cili perfshin informacion te detajuar sipas ameve dhe klasifikimeve buxhetore te Njesise se Veteqeverisjes Vendore.

Shpenzimet Kapitale te miratuara me VKB nr.06 dt.25.02.2025

Emertimi I Projektit	Kap	Prog.	Art.	Kodi I projektit	Vlera 2025	Vlera 2026	TOTALI
Rikonstruksion dhe rivitalizim i varrezave publike	5	6260	231	1180233	10,000,000		10,000,000
Rehabilitim dhe sistemim I rrugeve te qytetit dhe trotuareve	5	4520	231	1180208	20,000,000		20,000,000
Rikonstruksion Rruga Pavaresia Qerret	5	4520	231	1180209	40,000,000	40,000,000.00	80,000,000
Blerje Pemesh	5	6260	231	1180058	10,000,000		10,000,000
Blerje Stacione elektrike per karikimin e makinave	5	6260	231	1180250	2,000,000		2,000,000
Blerje mjete te renda per Bordin e Kullimit(eskavator+kamion me 8 akse)	1	4240	231	1180234	16,000,000		16,000,000
Rikonstruksion I Kopeshtit Mehmet Babamusta	5	6260	231	1180262	20,000,000	20,000,000.00	40,000,000
Instalim I kamerave te sigurise per objektet ne pronesi te Bashkise Kavaje	5	6260	231	1180099	15,000,000	15,000,000.00	30,000,000
Rehabilitim I sinjalistikes rrugore te qytetit dhe njesive	5	4570	231	1180235	10,000,000		10,000,000
Blerje ndriçuesish	5	6260	231	1180254	15,000,000		15,000,000
Ndertim I stacioneve te linjave te autobuseve dhe furgonave	5	6260	231	1180250	5,000,000		5,000,000
Implementim I software per Financen dhe Taksat	5	1110	231	1180251	15,000,000		15,000,000
Ndertimi I lulishteve	5	6260	231	1180245	28,000,000		28,000,000
TOTALI					206,000,000	75,000,000.00	281,000,000

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KAVAJE

Pasqyra Nr.4

Permbledhje e Shpenzimeve Kapitale Viti 2025 miratuar VKB nr.68 date 23.12.2024

/leke

P	Emertimi I Projektit	STRUKTURA GR.	TIT.	ART.	KODETE E PROJEKTIT	KOSTOJA E PROJEKTIT	BURIMI FINANCIMIT V.2024 : VITI 2025	VITI 2026	VITI 2027	TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR	TE ARDHURAT
I	Urbanistika										
1	Studim+projektim I rrugeve te qytetit te njesise Golem dhe qytetit	0	6140	230	1180258	27,000,000	27,000,000				27,000,000
2	Hartim projektim I Rruges se Bregdetit		6140	230	1180259	50,000,000	50,000,000				50,000,000
3	Mbikalimi I varrezave Qerret	0	4520	231		10,000,000				-	0
	Shuma I :				-	**87,000,000**	**77,000,000**	**0**	**0**	-	**77,000,000**
III	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi										
4	Blerje pajisje kompjuterike per Administraten e Bashkise	0	1110	231	1180241	5,000,000	5,000,000	0			5,000,000
5	Rikonstruksion I Godines se bashkise	0	1110	231	1180243	20,000,000	10,000,000	10,000,000	0		10,000,000
	Shuma II					**25,000,000**	**15,000,000**	**10,000,000**	**0**	-	**15,000,000**
	Sherbimet Publike Vendore										
	Ndertimi I tregut fruta perime	0	6260	231	1180238	27,000,000	10,000,000	17,000,000			10,000,000
6	Rivitalizim Urban I rruges Skuraj	0	4520	231	1180260	180,000,000	60,000,000	120,000,000			60,000,000
	Shuma III			231		**180,000,000**	**70,000,000**	**120,000,000**	**0**		**70,000,000**
7	Sport dhe Argetim dhe Kultura										
8	Rikonstruksion I Bustit te Deshmorit INDRIT CARA		8220	231	1180261	7,000,000	7,000,000				7,000,000
9	Hartim projektim per Ndertimin e Stadiumit BESA	0	8130	230	1180244	10,000,000	10,000,000			10,000,000	
10	Ndertimi I STADIUMIT	0	8130	231	1180244	300,000,000	90,000,000	100,000,000	100,000,000	90,000,000	
	Shuma IIII					**317,000,000**	**107,000,000**	**100,000,000**	**100,000,000**	**100,000,000**	**7,000,00**
	Totali I+II+III					**609,000,000**	**269,000,000**	**230,000,000**	**100,000,000**	**100,000,000**	**169,000,00**

Ky vendim hyn ne fuqi sipas percaktimeve te pikes 6 te nenit 55 te ligjit 139/2015 "*Per veteqeverisjen vendore*" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni Prefektit te Qarkut Tirane.

1. Rishperndarjen e fondeve ne Programin Rrjeti rrugor rural dhe Trashegimia Kulturore dhe Sporti si me poshte:

Emertimi	***Kap.***	***Zeri***	***Pakesohet /leke:***	***Shtohet /leke :***
Rikonstruksioni Rruga Pavaresia Qerret				
	05	231	7,000,000	
Rikonstruksioni i bustit Josif Budo				
	05	231		7,000,000
Shuma			**7,000,000**	**7,000,000**

DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE
SEKRETARI I GMS

ANDI ÇURGU

DREJTORIA LIGJORE

ADRIAN MALAJ

DREJTORIA E KULTURES,TRASHEGIMISE KULTURORE DHE SPORTIT

GENTIAN JAUPI

SEKRETARE E KESHILLIT

MERI BITURKU

K R Y E T A R I

FISNIK QOSJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KAVAJË

DREJTORIA E KULTURËS TRASHËGIMISË KULTURORE TURIZMIT DHE SPORTEVE

Nr _____ Prot

Kavajë me ___ / ___ /2025

RELACION

JOSIF BUDO, Dëshmori i Parë i Demokracisë

Josif Budo lindi me 7 Janar 1968. Ai u rrit në një familje shumë të respektuar kavajase i brumosur me shumë ëndrra për të ardhmen dhe i frymëzuar për një Shqipëri të lirë e demokratike si e gjithë Europa. Pikërisht për këtë arsye ai u bë pjesë e grupit të protestuesve që kundërshtonin fort diktaturën dhe regjimin komunist.

Kavaja ato ditë gumëzhinte nga lëvizjet dhe aksionet antikomuniste që kishin zanafillën ato ditë marsi të vitit 1990 e që më pas shpërthyen në korrik kur ra dëshmori i parë i demokracisë.

Sampistët po silleshin si egërsira…Vëllai i Sifit, Koli, po kacafytej me një nga forcat speciale me maskë. Sifit i kishte mbetur edhe pak bukë në dorë, por, kur pa vëllanë, menjëherë e la atë në një qoshk e u sul drejt sampistit egërsirë, që po qëllonte me grushte e me shkelma të vëllanë. Si shkëmbyen disa fjalë bashkë, gjendja u acarua shpejt e, duke përfituar nga momenti, sampisti nxori armën dhe e qëlloi Sifin . Djaloshi i pafajshëm ra i gjakosur në këmbët e turmës, që dha ulërimën. Plot njerëz të tjerë, të zemëruar, u mblodhën. Sampistët, të frikësuar, e morën menjëherë dhe si plumb pushke e çuan në spital, që t'i jepnin ndihmën e parë. Po djaloshi, trimi i nënës, Josif Budo, i kishte mbyllur sytë përgjithmonë. Ai që e kishte vrarë u fsheh nëpër terrin e natës në tarracën e shtëpisë së lindjes. I plagosur lehtë kishte mbetur edhe i vëllai i Sifit, Koli. Kolin e sollën shpejt në shtëpi, e futën në një dhomë, pa ia vënë veshin britmave të tij therrëse. Banorët e lagjes së çobanëve u sulën mbi sampistët e armatosur, derisa ata u detyruan e ikën drejt sheshit. Rrugës qëllonin me shkopinj gome cilindo që u dilte përpara syve. I qëllonin si të ishin armiq, sikurata njerëz nuk ishin vëllezërit e tyre shqiptarë. Rinia e Kavajës u dynd në spital. Ca çuna morën një çarçaf të bardhë në maternitet, mbështollën trupin e pajetë të Josifit dhe marshuan drejt qendrës së qytetit, duke qëndruar për disa minuta aty. Pastaj e ngritën prej andej dhe nisën ta shëtisnin nëpër qytet të heshtur. Heshtja e atyre të rinjve kishte një domethënie të madhe. Ajo heshtje sikur u fliste qytetarëve, prindërve kavajas: zgjohuni, ejani me ne, se bisha komuniste kërkon gjak nga që është në orët e saj të fundit! Trupin e Sifit e sollën vonë në shtëpi; atë e vendosën te çimentoja e pusit për t'i larë gjakun, që kishte rrëshqitur në formë shiritash të kuq. Në shtëpi filloi gjëma e madhe. Nuk dije cilin të mbaje më parë nga njerëzit e shtëpisë: mëmë Silën, që kishte humbur fare, babë Kiçon, që shkulte flokët e tij, vëllezërit, motrat, xhaxha Koçin, që I binte kokës me grushte, xhaxheshën Liri, me djalin dhe vajzat e saj, sepse ata ishin rritur bashkë në një shtëpi e në një sofër! Unë vetë kam qenë dëshmitare okulare, kur vranë Josif Budon dhe plagosën të vëllanë, Kolin. Nga dhimbja

për Sifin, Kolin e gjorë e harruan fare, koka sa vinte e po i enjtej, sepse plumbi kishte mbetur brenda. Dhimbjet i shtoheshin. Kërkuan një mjek, po nuk vinte njeri nga frika. Të bërtiturat e tij nuk duroheshin. Aty nga ora 2-3 e natës erdhën një mjek dhe një infermiere e urgjencës, që ia hoqën plumbin e ngecur. Nuk i harroj ato çaste dramatike, të bërtiturat e mëdha rrëqethëse, kur ia hoqën. Nga ato që ndodhën në Kavajë, gjarpri në pushtet, nisi forca të shumta ushtarake në këtë qytet për t'u hakmarrë. Kështu ai tregoi fytyrën e tij shtazarake sikur donte të thoshte: "Jam ende i fortë e nuk dorëzohem!"

Të nesërmen në të gjitha ndërmarrjet u dha urdhri: asnjë të mos marrë pjesë në varrimin e Josifit! Por gabuan rëndë. Varrimi i Josif Budos ishte madhështor. Jo vetëm nga qyteti, por dhe nga fshatrat kishin ardhë për t'i bërë nderimet e fundit e për t'i dhënë lamtumirën heroit të demokracisë. Arkivolin e Josifit e çuan në kishë, që u hap për herë të parë, pas prishjes së fesë. Meshën e bëri dizenjatori i komunales, Petraq Isaku, ish-klerik, që kishte qenë shok klase me Papa Vojtilën. Kisha, pas prishjes më 1967, ishte bërë pallat kulture. Atë ditë u rihap për herë të parë e nga ajo ditë u kthye në origjinë. Arkivoli qe mbuluar me një copë të bukur e me buqeta lulesh dhe shokët e mbajtën në krahë, deri në banesën e fundit. Kavaja ishte e gjitha në zi.

Nëpër ballkone e porta nënat e motrat kavajase qanin nga larg djalin dhe vëllanë e tyre. Kortezhi, para se të merrte rrugën për në varreza, eci drejt lagjes Sharrë. Nuk kishte humbur vetëm familja Budo të dashurin e tyre, por e gjithë Kavaja kishte humbur djalin e saj. Fati i takoi Josif Budos që të bëhej ai kurban në themelet e fortesës së demokracisë. Pas varrimit të Josifit, në ditët në vijim revoltat u përshkallëzuan, pa ndërprerje. Populli dilte nëpër rrugë dhe kërkonte me zërin e protestës largimin e Ramiz Alisë e kukullave të tij nga pushteti. Dhe ashtu ndodhi.

Josif Buda mban titullin "Dëshmor i parë i Demokracisë" dhe është shpallur "Qytetar nderi i Kavajës për çështjen kombëtare", një rrugë në Kavajë dhe një në Tiranë mban emrin e tij.

Nga libri "Të falësh... Fisi i vjetër kavajas Cara", botim i ISKK

DREJTORI

Gentian JAUPI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KAVAJË

DREJTORIA E KULTURËS TRASHËGIMISË KULTURORE TURIZMIT DHE SPORTEVE

Nr _____ Prot

Kavajë me ___ / ___ /2025

Lënda: Kërkesë për mundësinë e ndërtimit të shtatores të Josif Budo

Drejtuar: Kryetar i Bashkisë Z.FISNIK QOSJA

Për dijeni: Sekretari i Përgjithshëm Arti Çiçolli

Me rastin e 35 vjetorit të rënies së Dëshmorit Josif Budo, dëshmorit të parë të demokracisë, kërkojmë rikonceptimin dhe rindërtimin e një shtatoreje të denjë për dimensionin dhe rëndësinë e kësaj figure në lëvizjet antikomuniste të fillim viteve 90'

Duke ecur në gjurmët e rindërtimit të shtatores së Indrit Carës, si hero i kombit, sugjerojmë të ndërtohet një monument edhe për figurën më të rëndësishme të lirisë dhe demokracisë, jo vetëm për Kavajën por për të gjithë Shqipërinë. Në këtë mënyrë, në aspektin simbolik, të dyja këto figura do të konsideroheshin të rehabilituara me vepra artistike që u shkojnë për shtat figurës së tyre.

Ky propozim vjen si pasojë e kujtesës kombëtare, për të nderuar figurat historike që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në rrugën e demokracisë dhe me dëshirën për të ruajtur dhe promovuar kujtesën historike tek brezat e rinj, paraqesim këtë kërkesë për ndërtimin e një busti për Heroin e Demokracisë, Josif Budo.

Josif Budo është një simbol i sakrificës dhë qëndresës për idealet demokratike, dhe vlerësojmë se vendosja e bustit të tij në qendër të qytetit ku u lind dhe u rrit do të jetë një vlerë e shtuar kulturore, historike dhe edukative për komunitetin.

Për të nderuar veprën e Heroit të Parë të Demokracisë në përvjetorin e 35-të, të rënies së tij, kerkojmë nga ana juaj, shqyrtimin e mundësive për të nisur procedurat me qëllim ndërtimin e kësaj vepre e cila duhet ti shkoje per shtat madhësisë dhe dimensionit të kësaj figure mbarëkombëtare.

DREJTORI

GENTIAN JAUPI

PREVENTIV

Nr	Nëntitull	Përshkrimi i detajuar	Njësia	Sasia	Çmimi Njësor (ALL)	Shuma (ALL)
1	Projektim & dizajn	Skica 2D/3D, dilema teknike, planxhet për tender	shërbim	1	350,000	350,000
2	Modelizim gipsi (maquette)	Model miniatural me detaje plastike, për përcaktim përfundimi	shërbim	1	450,000	450,000
3	Kallëp silikoni/çimento	Konstruksion kallëpi për derdhje precize	shërbim	1	550,000	550,000
4	Material bronxi	Furnizim bronxi (Cu + Zn + Sn) cilësi artistike	kg	400	7,000	2,800,000
5	Derdhje & ngurtësim	Proces ngrohjeje, derdhje, pastrim, furrë furnizimi	shërbim	1 copë	600,000	600,000
6	Përpunim sipërfaqësor	Gërmim, lustër dhe trajtim anti-korroziv	shërbim	1 copë	400,000	400,000
7	Ndërtim bazamenti prej betoni	Beton klasë B25, dimensione cilindër ø150 cm, lartësi 1 m (volum ~1.77 m^3)	m^3	1.77	45,000	79,650
8	Shtresë hidroizolim bazamenti	Fasada me trajtim mbrojtës për beton	m^2	7.07	5,000	35,350
9	Veshje me mermer/granit	Pllakë dekorative tip "hiringa", e prerë sipas diametrit 1.5 m	m^2	7.07	25,000	176,750

Nr	Nëntitull	Përshkrimi i detajuar	Njësia	Sasia	Çmimi Njësor (ALL)	Shuma (ALL)
10	Transport	Ngarkim, transport me kamion, shkarkim në vendin e instalimit	shërbim	1	200,000	200,000
11	Ngritje & montim	Krahë me vinç, punë me specialistë në terren	shërbim	1	250,000	250,000
12	Ndriçim dekorativ LED	Instalim llambash LED rreth bazamentit + kabuj + furnizim	shërbim	1	150,000	150,000
13	Arrimit të ambientit	Punime pllakesh, rrafsimi, gjelbërim i thjeshtë, tabelë informuese	shërbim	1	250,000	250,000
14	Administrim & studim	Leje urbane, kontrolle strukturore, analiza ngarkese, raportim për tender	shërbim	1	300,000	300,000
15	Rezervë për papritura (10%)	Garancë për ndryshime çmimesh të materialeve, papritura gjeo/përparësie punimesh	-	-	-	657,250

Totali i shpenzimeve: 7,000,000 ALL